



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data



Nr. 02/09

Datë: 22.04.2016

Në mbështetje të nenit 52, nenit 53, nenit 30 paragrafi (1 dhe 2) i Ligjit Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenit 7 (paragrafi 9) i Rregullores së Punës Nr. 20/2011 të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Këshilli i Agjencisë në mbledhjen e mbajtur më 22.04.2016, mori :

V E N D I M


1. Plotësohet dhe ndryshohet vendimi Nr. 02/04 i datës 21.02.2014.
2. Nga lista e vendeve dhe organizatave ndërkombëtare me nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave hiqen: Organizatat që janë pjesë e Programit Safe Harbour.
3. Lista e vendeve dhe organizatave ndërkombëtare me nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale i bashkëngjitet këtij vendimi.
4. Lista e aprovuar publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në web faqen zyrtare të Agjencisë.
5. Vendimi hyn në fuqi pas publikimit në Gazetën Zyrtare.

Vendimi i dërgohet:

- Gazetës Zyrtare
- Anëtarëve të Këshillit
- Arkivit të Agjencisë

Këshilli i Agjencisë

Ruzhdi JASHARI


Mbikëqyrës Kryesor Shtetëror

Lista e vendeve dhe organizatave ndërkombëtare që cilat sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale përmban shtetet si më poshtë:

- Austri
- Belgjikë
- Bullgari
- Kroacia
- Qipro
- Republika Çeke
- Danimarkë
- Estoni
- Finlandë
- Francë
- Gjermani
- Greqi
- Hungari
- Irlandë
- Itali
- Letoni
- Lituani
- Luksemburg
- Maltë
- Holandë
- Poloni
- Portugali
- Rumani
- Sllovaki
- Slloveni
- Spanjë
- Suedi
- Britani e Madhe
- Izraeli
- Uruguai

Shtetet anëtare të “Zonës Ekonomike Evropiane” konkretisht listohen:

- Islandë
- Lihtenshtein
- Norvegji
- Zvicër

Në mbështetje të nenit 53 (paragrafi 2), "Agjencia mund të zbatojë vendimet e marra nga organi kompetent i Bashkimit Evropian nëse vendet e tilla dhe organizatat ndërkombëtare sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave", ku Komisioni Evropian deri më tani ka marrë këto Vendimet mbi përshtatshmërinë e mbrojtjes së të dhënave personale në vendet e treta:

1. Argjentinë

Vendim i Komisionit C(2003) 1731 i datës 30 Qershor 2003 - OJ L 168, 5.7.2003.

(Opinion 4/2002 për nivelin e mbrojtjes së të dhënave personale në Argjentinë, dokumenti Nr. Grupi i Punës 63);

2. Australia

Vendimi i Këshillit - 2008/651/CFSP/JHA i datës 30 qershor 2008 me nënshkrimin, në emër të Bashkimit Evropian, e marrëveshjes midis Bashkimit Evropian dhe Australisë mbi përpunimin dhe transferimin e të dhënave të regjistrimit të emrave të udhëtarëve që kanë burimin në Bashkimin Evropian, përmes bartësve ajrorë në Shërbimin e Doganës Australiane; OJ L213 i datës 08/08/2008, f.47-48.

MARRËVESHJA midis Bashkimit Evropian dhe Australisë mbi përpunimin dhe transferimin e të dhënave të regjistrimit të emrave të udhëtarëve që kanë burimin në Bashkimin Evropian, përmes bartësve ajrorë në Shërbimin e Doganës Australiane; OJ L213 i datës 08/08/2008, f.49-57.

3. Andora

Vendimi i Komisionit C(2010) 7084 i datës 19 Tetor 2010 - OJ L 277/27, 21.10.2010

(Opinion 7/2009 për nivelin e mbrojtjes së të dhënave personale në Principatën e Andorës, dokumenti Nr. Grupi i Punës 166);

4. Kanada

Vendim i Komisionit 2002/2/EC i datës 20.12.2001 për mbrojtjen e mjaftueshme të dhënave nga Ligji Kanadez për Mbrojtjen e Informacionit Personal dhe Dokumenteve Elektronikë - O.J. L 2/13 of 4.1.2002 (Opinion 2/2001 për mbrojtjen e mjaftueshme të dhënave nga Mbrojtja e Informacionit Personal Kanadez dhe Dokumenteve Elektronikë Akti, dokumenti Nr. Grupi i Punës 39);

5. Guernsey

Vendim i Komisionit i datës 21 Nëntor 2003 për mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave në Guernsey.

(Opinion 5/2003 për nivelin e mbrojtjes së të dhënave Guernsey, dokument Nr. Grupi i Punës 79);

6. Ishulli i Man

Vendim i Komisionit 2004/411/EC datë 28.4.2004 për mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave në Isle of Man.

(Opinion 6/2003 për nivelin e mbrojtjes së të dhënave personale në Ishullin e Man, dokumenti nr Grupi i Punës 82);

7. Jersey

Vendim i Komisionit i datës 8 Maj 2008 sipas Direktivës 95/46/EC i Parlamentit Evropian dhe Këshillit për nivelin e mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave në Jersey (i njoftuar sipas dokumentit numër C(2008) 1746) - OJ L 138, 28.05.2008

(Opinion 8/2007 për nivelin e mbrojtjes së të dhënave në Jersey, dokumenti nr. Grupi i Punës 141);

8. Ishujt Faroe

Vendim i Komisionit i datës 5 Mars 2010 sipas Direktivës 95/46/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për nivelin e mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale të parashikuar në aktin e Ishujve Faroe për përpunimin e të dhënave personale; dokument C(2010)1130

9. Zelanda e Re

Vendimi i Komisionit i datës 19 Dhjetorit 2012 sipas Direktivës 95/46/EC e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për nivelin e mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale nga Zelanda e Re (i njoftuar sipas dokumentit C(2012) 9557) - OJ L 28, 30.01.2013).

(Opinion 11/2011 për nivelin e mbrojtjes së të dhënave në Zelandën e Re, dokumenti nr. Grupi Punës 182);